



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/63
Datë: 07.05.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 07 maj 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 62 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/63
Datë: 07.05.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 07 maj 2009, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i jep mbështetje propozimit të Komisionit qeveritar për problemin e licencimit të studentëve biologë që:
 - 1.1 Licencimi i të diplomuarve në drejtimin Biologji aplikative (inxhinier i biologjisë) si dhe atyre Biokimiko - Fiziologjik (master i këtij drejtimi) të bëhet në kuadër të legjislacionit ekzistues, nenit 86 (h) të Ligjit mbi Shëndetësinë, vetëm pasi ata do t'i plotësojnë edhe kushtet tjera shtesë që do të cekën në pikat në vazhdim. Ata do të marrin thirrjen laborant i lartë mjekësor. Të diplomuarit në thirrjen Bachelor të drejtimit Biokimiko - Fiziologjik e marrin thirrjen laborant i diplomuar.
 - 1.2 Obligohet Rektorati i Universitetit të Prishtinës që në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë dhe atë të FSHMN-ës që në afat sa më të shkurtër kohor (më së largu 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi) të përgatisë një cikël plotësues të lëndëve mjekësore kompatible me thirrjen e laborantëve të lartë mjekësor. Këtë program kanë të drejtë ta vijnë të diplomuarit në drejtimin Biologji Aplikative (inxhinier i biologjisë) si dhe ata të drejtimit Biokimiko - Fiziologjik që e kanë titullin master.
 - 1.3 Të gjithë kandidatët e diplomuar duhet të plotësojnë stazhin themelor në institucionet shëndetësore të licencuara që ofrojnë këto shërbime shëndetësore. Kohëzgjatja e këtij stazhi është 6 muaj. Kandidatët stazhin mund ta bëjnë paralelisht me lëndët shtesë që ata duhet t'i ndjekin sipas vendimit nga pika 2.

- 1.4 Pas përfundimit të ciklit të lëndëve mjekësore (kandidatët për laborant të lartë mjekësor) dhe stazhit 6 mujor (të gjithë kandidatët), krijohen kushtet kur ata mund të parashetrojnë kërkesën për dhënie e provimit profesional dhe t'i nënshtrohen provimit final të licencës sikur të gjithë punëtorët tjerë shëndetësor.
 - 1.5 Kandidatët e licencuar i gëzojnë edhe të drejtat tjera të parapara në bazë të Ligjit për Shëndetësi.
 - 1.6 Ministria e Shëndetësisë obligohet që zyrtarisht t'i njoftojë të gjitha institucionet shëndetësore që kandidatët e licencuar në bazë të këtij vendimi t'i trajtojë si të gjithë profesionistët të tjerë shëndetësor.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/63
Datë: 07.05.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 07 maj 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Udhërrëfyesi për Implementimin e Kritereve për Procesin e Liberalizimit të Vizave në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Bartëse e këtij procesi do të jetë Ministria e Punëve të Brendshme.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që të hartojë Planin e Veprimit për implementimin e Udhërrëfyesit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjitha ministratë relevante që do të jenë pjesë e Planit të Veprimit.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/63
Datë: 07.05.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4., 93 paragrafi (4) dhe nenit 96 paragrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës Nr. 01/2007, duke marrë parasysh rekomandimet preliminare të projektit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike) FRIDOM – Rishikimi funksional dhe organizimi institucional i ministrive: Rishikimi i gjithë Qeverisë – Raporti preliminar me 20 sugjerime për të përmirësuar organizimin e Qeverisë së Kosovës dhe portofoleve të saj – nëntor 2008, si dhe duke marrë parasysh Raportet Analitike të Rishikimit funksional të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe pas shqyrtimit dhe propozimit të Komisionit Ndërmintor për Reformën në Administratën Publike (KNRAP) (të emëruar me Vendimin e Qeverisë nr. 04/22 të datës 30.05.2008), dhe me qëllim të përmirësimit të organizimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në pajtim me sugjerimet e dhëna nga raportet analitike të rishikimit funksional, për Qeverinë si tërësi dhe për tri ministrin e caktuara, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 07 maj 2009, mori

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DALA NGA PROCESI I RISHIKIMIT
FUNKSIONAL DHE ORGANIZIMIT INSTITUCIONAL**


Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me rekomandimet e dhëna nga raportet analitike të rishikimit funksional, për Qeverinë si tërësi dhe për tri ministrin të caktuara: Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe me qëllim të përmirësimit të organizimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërmerr hapat në vijim:

1. Në periudhën e parë gjashtëmujore të ndërmerren hapat në vijim:
 - 1.1 Ministria e Shërbimeve Publike shndërrohet në Ministri të Administratës Publike (MAP);

- 1.2 Ministria e Administratës Publike do të jetë përgjegjëse për procesin e Reformimit të Administratës Publike në Republikën e Kosovës dhe do të ushtrojë detyrat tjera në pajtim me Shtojcën IX të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 të ndryshuar me Rregulloren Nr. 2005/53 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe legjislacionit tjetër në fuqi që ka të bëjë me Ministrinë e Shërbimeve Publike, deri me nxjerrjen e Rregullores për Organizimin dhe strukturimin e Ministrisë së Administratës Publike që do të propozohet nga Ministri i Ministrisë së Administratës Publike dhe të aprovohet nga Qeveria;
- 1.3 Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil (DASHC), në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike të ristrukturohet, në pajtim me rekomandimet e dala me rastin e rishikimit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, si dhe divizionet të riorganizohen si vijon: Divizioni i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Kapaciteteve; Divizioni i Informacionit për Administrimin e Burimeve Njerëzore; Divizioni i Pagave dhe Organizimi Funkcional;
- 1.4 Divizioni i Reformës për Administratën Publike, në kuadër të MSHP-ës, të shndërrohet në Departament për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike;
- 1.5 Departamenti i Teknologjisë Informative (DTI), në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike, të ristrukturohet në pajtim me rekomandimet e dala me rastin e rishikimit funksional, respektivisht të E-Qeverisjes, duke u fokusuar më tepër në detyrat lidhur me politikat dhe më pak në shërbimet themelore të Teknologjisë Informative nëpër institucione;
- 1.6 Departamenti i Shërbimeve të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave (DSHIMN)), në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike, të ristrukturohet në pajtim me rekomandimet e dala dhe të krijon një divizion të ri për politikat, gradualisht të heq divizionin e inxhinieringut dhe divizionin e mirëmbajtjes së ndërtesave, dhe të krijon një divizion të ri të investimit në ndërtesa, prokurimit dhe kontrollit mbikëqyrës;
- 1.7 Agjencia Kadastrale e Kosovës kalon nga kompetencat e Ministrisë së Shërbimeve Publike në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor;
- 1.8 Departamenti për Administratë Qendrore, në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike, të shkrihet si departament dhe divizionet e tij të ristrukturohen dhe të administrohen drejtpërdrejt nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Administratës Publike;
- 1.9 Ministria e Punëve të Brendshme të themelojë Agjencinë për Regjistrimin Civil, që do të ofrojë të gjitha shërbimet për qytetarët dhe rezidentët që aplikojnë për kartela identiteti, pasaporta, nënshtetësi, dokumente për gjendje civile, patentë-shoferët dhe dokumentet për regjistrimin e automjeteve;

- 1.10 Ministria e Punëve të Brendshme të themelojë departament për të koordinuar hartimin dhe zbatimin e politikave dhe monitorimit të Policisë së Kosovës, Inspektoratit të Policisë së Kosovës dhe Qendrës Kosovare për Edukim dhe Zhvillim;
 - 1.11 Ministria e Punëve të Brendshme të shqyrtojë mundësinë që shërbimet e zjarrfikësve dhe të shpëtimit të largohen nga komunat dhe të themelohet një agjenci unike për Zjarrfikës dhe Reagim Emergjent mbi bazën e një pjese të departamentit aktual për Menaxhim të Emergjencave;
 - 1.12 Të bëhet riorganizimi i pjesës së mbetur të Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave duke ndarë qartë mbikëqyrjen e Agjencisë së re dhe përgjegjësitë përkatëse rregullative nga funksioni i vlerësimit të rrezikut emergjent kombëtar, planifikimi dhe koordinimi i masave për reagim;
 - 1.13 Departamenti për Siguri Publike të bëhet operacional dhe të fokusojë aktivitetin i tij në çështjet që kanë të bëjnë me rregullat për armë të lehta, eksplozive civile dhe licencim të kompanive private të sigurisë;
 - 1.14 Ministria e Punëve të Brendshme të themelojë Departamentin për Nënshitetësi, Azil dhe Migracion, si dhe të qartësohen përgjegjësitë ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës në fushën e azilit dhe migracionit derisa të bëhet përforcimi i funksioneve për azil dhe migracion;
 - 1.15 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të fillojë me përgatitjet dhe aplikimin e strategjisë së re për zhvillimin e burimeve njerëzore për të përforcuar kapacitetet ministrore;
 - 1.16 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të bëjë Rishikimin e përshkrimit të punës për divizionin e BNj.
 - 1.17 Të bëhet procesi i Riorganizimit të përgjithshëm të monitorimit në MAPL dhe riorganizimi i divizioneve aktuale të DPL në raport me riorganizimin e funksionit të monitorimit.
1. Të vazhdohet me zbatimin e rekomandimeve të dala me rastin e Rishikimit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të cilat tanimë janë të inkuorpuara në kuadër të Projektligjit për Shërbimin Civil, i cili u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 24 prill 2009.
 3. Ministrat e ministrive përkatëse, që kanë të bëjnë me këtë vendim, ndërmarrin të gjitha masat për zbatimin e këtij vendimi, duke përfshirë edhe iniciimet për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe do të raportojnë në afat prej gjashtë muajsh për progresin e arritur në këtë drejtim.

4. Obligohen të gjitha organizata buxhetore të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/63
Datë: 07.05.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-086 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Mbeturinave, si dhe të nenit 4, paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 07 maj 2009, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Kosovës ia rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor të Zyrës Rregullative të Ujësjetës dhe Mbeturinave:
 - a) Raif Preteni
 - b) Kero Bardhi
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat e kandidatëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, së bashku me CV-të e tyre, t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/63
Datë: 07.05.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 7.000 (shtatëmijë) Euro për familjen e dëshmorit të kombit, Sami Rama.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga fondi "Rezervat e Paparashikuara" të Qeverisë dhe derdhen në xhirollogarinë bankare: NLB - Prishtina Nr. : 1701003014191503.
3. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/63
Datë: 07.05.2009


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L - 048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, si dhe nenit 4 pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2009, mori

V E N D I M

1. Bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr. 02/48 të datës 24.12.2008, mbi miratimin e Skemës së Fondit për Kuadro, përcaktohet niveli maksimal i shpërndarjes së mjeteve financiare si më poshtë :

	Organizata Buxhetore	Shuma	Numri i përfituesve
1	Zyra e Kryeministrit	100,000 €	5 -11
2	Ministria e Arsimit	80,000 €	4 - 8
3	Ministria e Drejtësisë	80,000 €	4 - 8
4	Ministria e Ekonomisë dhe Financave, përfshirë Administratën Tatimore të Kosovës, Doganat e Kosovës, dhe Transferet Automatike të Njesisë së Makroekonomisë dhe PPPsë	300,000 €	14 - 31
5	Ministria e Shëndetësisë	80,000 €	4 - 8
6	Ministria e Transportit	80,000 €	4 - 8
7	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	80,000 €	4 - 8
8	Ministritë tjera - 11 në tërësi (25,000 € për secilën)	275,000 €	13 - 29
	Total	1,075,000 €	50 - 112

2. Mjetet do të barten tek organizatat buxhetore vetëm pasi të përcaktohen procedurat e shfrytëzimit të fondit.
3. Miratohet propozimi për angazhimin e Menaxherit të Projektit *Fondi për Kuadro*, i cili ka për detyrë funksionalizimin e Skemës së Fondit për Kuadro bazuar në procesin e propozuar në raportin e GAP-it (raporti i bashkangjitur në këtë vendim) dhe nevojat e domosdoshme që parashihen nga Qeveria për të siguruar efektivitet në implementimin e këtij projekti.
4. Menaxheri i Skemës së Fondit të Trurit do ti raportojë Zyrës së Kryeministrit.
5. Niveli i pagesës së Menaxherit të Projektit do të jetë 1,000 € në muaj. Mjetet për pagesën e Menaxherit të Projektit do të barten nga “Fondi për Kuadro,” kodi programor 244, në Zyrën e Kryeministrit, kodi programor 10600, kategoria paga dhe mëditje.
6. Mjetet për pagesën e Transfereve Automatike të stafit ekzistues të Njesisë për Politika Makroekonomike dhe Njesisë së PPPsë do të barten nga “Fondi për Kuadro”, kodi programor 244, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, kodi programor 11301, kategoria paga dhe mëditje, me efekt nga 1 qershor 2009.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Kryeministrit.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Hashim Thaci
Kryeministër i Kosovës

Ju dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë